Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0992

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Gani B. Krasniqi B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) me numër të prokurimit 11600-25-4483-2-1-1, me 12/11/2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Gani B. Krasniqi B.I. me nr. 2025/0992, e datës 07/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) me numër të prokurimit 11600-25-4483-2-1-1.

2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) me numër të prokurimit 11600-25-4483-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Gani B. Krasniqi B.I.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.05.2025ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) me numër të prokurimit 11600-25-4483-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 275,000.00 €.

Me 22.09.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE Mirsad Gashi B.II.

Me 26.09.2025, OE Gani B. Krasniqi B.I., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 07.10.2025.

Me 07.10.2025, OE Gani B. Krasniqi B.I., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0992, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Gani B. Krasniqi B.I., lidhur me ankesën 0992/2025:

Pretendimin ankimor nr. 1

Në Seksionin II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me nr. 1 është kërkuar:

Kërkesa 1: Listën me të cilën specifikohen kontrata ose kontratat për servisimet e veturave të operatorit ekonomik të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar shërbimet, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale — Evidenca 1: Operatori ekonomik duhet të plotësojë listën e kontratave për servisimin e veturave, që është formulari i dhënë në Aneksin 8 të dosjes së tenderit, dhe të bashkëngjisë si dëshmi referencë ose referencat, ose kur është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e faturës e nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë. Kërkohet vlera 130,000.00 euro për pjesën 1 dhe pjesën 2; ndërsa kërkohet vlera 50,000.00 euro për pjesën 3 dhe pjesën 4. Në rast se ofertuesit ofertojnë si konsorcium, nga lideri i grupit të OE kërkohet të ketë së paku 70% të vlerës së referencës/referencave për servisim të automjeteve.

Duke u bazuar në OE-në e rekomanduar për kontratë “Mirsad Gashi B.I.” dhe marrë parasysh se jemi konkurrent me OE-në në institucionet e Republikës së Kosovës dhe marrim pjesë në aktivitete të njëjta të prokurimit për servisime dhe mirëmbajtje të automjeteve, supozojmë se ky OE nuk posedon referenca për punë të kryera në vlerë prej 180,000.00 euro në tri vitet e shkuara, siç është kërkuar në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Po ashtu, duke e pasur parasysh edhe kërkesën për konfidencialitet të neneve 68 dhe 69, është argument që të jepet me kuptuar se OE-ja nuk e plotëson këtë kërkesë të parapara në NJF dhe DT.

Pretendimin ankimor nr. 2:

Në Seksionin II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me nr. 3 është kërkuar:

Kërkesa 3: Hapësira e objektit të servisit kërkohet të jetë minimum 250 m² me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontratë për marrje me qira, për të cilën duhet të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë reshjet, era, pluhuri. Hapësira e objektit të servisit duhet të jetë larg në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e objektit të AK-së, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” & “Bill Clinton”, Prishtinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese — Evidenca 3: Hapësira e objektit të servisit të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontratë për marrje me qira, për të cilën duhet të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Hapësira e objektit të servisit të dëshmohet me dëshmi me shkrim mbi vendndodhjen dhe largësinë e servisit në rrugë tokësore maksimumi 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e AK-së me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” & “Bill Clinton”, Prishtinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Duke u bazuar në OE-në e rekomanduar për kontratë “Mirsad Gashi B.I.” dhe marrë parasysh se jemi konkurrent me OE-në në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe marrim pjesë në aktivitete të njëjta të prokurimit për servisime dhe mirëmbajtje të automjeteve, supozojmë se OE nuk posedon hapësirën e objektit të servisit prej 250 m². OE-ja “Mirsad Gashi B.I.” në aktivitete të prokurimit prezanton një dokument Leje të Objektit me sipërfaqe prej 250 m². Objekti përfshin dy pjesë të objektit për servisimin, 8x10 = 80 m² dhe 8x10 = 80 m², ku gjithsej bëjnë 160 m² hapësirë e objektit për servisim të automjeteve. Një pjesë të objektit e posedon depo për autopjesë, që besohet të dëshmohet edhe me foto të prezantuara nga vetë OE-ja, dhe nga i njëjti objekt është një pjesë zyre dhe kafé e cila shërben për nevojat e OE-së. OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk posedon hapësirën e objektit për servisim prej 250 m². OE-ja te AK-ja ka prezantuar dokumente të objektit prej 250 m², por në të njëjtin objekt janë të përfshira edhe hapësirat për shitjen e autopjesëve, hapësirat e zyrave dhe hapësira e quajtur “kafe” për nevojat e servisit.

Në këtë rast, AK-ja respektivisht komisioni vlerësues, konform nenit 59 “Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve”, paragrafi 2 (“Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo aspekt të tenderit të tij”), mund të duhej të kërkonte sqarim, në mënyrë që të bëhej ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve. Oferta e dorëzuar nga OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftim dhe dosjen e tenderit.

Në atë hapësirë të ofruar prej 250 m² janë të përfshira dy pjesë të objektit të servisit, depoja, zyra etj. AK-ja përmes fotove të dorëzuara mund ta verifikojë këtë. Po ashtu kërkojmë nga AK-ja dhe ATK-ja, duke u bazuar në nenin 59, që komisioni i vlerësimit të bëjë një vizitë te OE-ja i rekomanduar për kontratë dhe të argumentojë pretendimet tona ankimore lidhur me hapësirën e objektit të OE-së së rekomanduar për kontratë. Gjithashtu, në vendimin e AK-së për kërkesën për rishqyrtim të kompanisë tonë, të na dëshmojë me fotografi se si duket hapësira e OE-së.

Pretendimin ankimor nr. 3:

Në Seksionin II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me nr. 4 është kërkuar:

Kërkesa 4: Dëshmi mbi disponimin e mjeteve apo pajisjeve teknike në dispozicion: vinç hidraulik për ngritjen e automjeteve – së paku 4 (katër) vinça; pajisje speciale (kompjuteristike) për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve – së paku 1 (një); pajisje për vullkanizim dhe balansim të gomave – së paku 1 (një); pajisje për mbushjen e klimave të automjeteve – së paku 1 (një) (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese — Evidenca 4: Pajisjet e kërkuara të dëshmohen me faturë, foto ose dokumentacion tjetër dëshmues mbi pronësinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Duke u bazuar në OE-në e rekomanduar për kontratë “Mirsad Gashi B.I.” dhe marrë parasysh se jemi konkurrent me OE-në në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe marrim pjesë në aktivitete të njëjta të prokurimit për servisime dhe mirëmbajtje të automjeteve, supozojmë se nuk posedon në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike dhe nuk ka arritur t’i dëshmojë AK-së me dokumente dëshmuese pajisjet e kërkuara, si vinç hidraulik për ngritjen e automjeteve, pajisje speciale kompjuteristike për diagnostifikimin e defekteve, pajisje për vullkanizim dhe balansim të gomave dhe pajisje për mbushjen e klimave të automjeteve.

Për të njëjtat pajisje teknike, OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk posedon ndonjë dëshmi faturë ose dokumentacion dëshmues që i posedon në pronësi. OE-ja, përpos fotos, nuk posedon asnjë dëshmi tjetër dëshmuese mbi dëshmimin e mjeteve dhe pajisjeve. Fotografia nuk është dokument dëshmues, ndërsa në NJF dhe DT, AK-ja ka kërkuar qartë: “Dëshmi mbi disponimin e mjeteve apo pajisjeve teknike në dispozicion”.

Pretendimin ankimor nr. 4:

Në Seksionin II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me nr. 5 është kërkuar:

Kërkesa 5: Automjet për bartjen – tërheqjen e automjeteve në rast defekti në rrugë. Kërkohet automjeti transportues (kamioni) për tërheqjen e automjeteve të vogla (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese — Evidenca 5: Automjeti për bartjen – tërheqjen e automjeteve të dëshmohet me fotografi dhe librezë valide të regjistrimit të automjetit (kamionit) në emër të kompanisë ose me kontratë/marrëveshje të marrë me qira (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Duke u bazuar në OE-në e rekomanduar për kontratë “Mirsad Gashi B.I.” dhe marrë parasysh se jemi konkurrent me OE-në në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe marrim pjesë në aktivitete të njëjta të prokurimit për servisime dhe mirëmbajtje të automjeteve, supozojmë se nuk posedon në dispozicion automjet për bartjen dhe tërheqjen e automjeteve. OE-ja posedon një rimorkio për bartjen e automjeteve, e cila nuk është në përputhje me NJF dhe DT.

Po ashtu, OE “Mirsad Gashi B.I.” posedon edhe marrëveshje me qira për automjetin për bartjen–tërheqjen e automjeteve. Kontrata nuk është e plotfuqishme, pasi që është e mangët; nuk specifikohen të gjitha shërbimet e qiradhënësit dhe qiramarrësit. Në kontratë nuk janë të detajuara dhe të sqaruara përgjegjësitë e palëve kontraktuese, ku në kontratë duhet të specifikohet që për periudhën kohore të ekzekutimit të kontratës deri në përfundim, automjeti për bartjen–tërheqjen e automjeteve duhet të qëndrojë në hapësirat e parkingut të OE-së së rekomanduar për kontratë.

Kontrata nuk është në përputhje me Ligjin nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, pasi në të mungojnë detyrimet e palëve dhe ka shumë mangësi të tjer.

Pretendimin ankimor nr. 5:

Në Seksionin II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me nr. 6 është kërkuar:

Kërkesa 6: Deklaratë me shkrim për shërbimet dhe mallrat e ofruara, të cilat do të jenë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese — Evidenca 6: Të dorëzohet deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe vulosur nga OE për shërbimet dhe mallrat e ofruara, të cilat do të jenë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Me datë 23.09.2025, kur na është lejuar qasja në dokumentacionin e OE-së së rekomanduar për kontratë “Mirsad Gashi B.I.”, kemi marrë edhe deklaratën dhënë nga OE-ja për kryerjen e shërbimeve në pajtueshmëri me specifikacionet teknike të kërkuara në NJF dhe DT. Deklarata nuk është e vulosur nga OE-ja i rekomanduar për kontratë; deklarata është vetëm e nënshkruar.

Kërkesa me nr. 6 në FDT ka qenë që duhet të dorëzohet deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Deklarata e shërbimeve të cilën ne e posedojmë nga OE-ja i rekomanduar nuk është e vulosur dhe i mungon vula, sipas kërkesave të paraparë në NJF dhe DT.

Në këtë rast, duke u bazuar në Udhëzuesin nr. 002/2024 për plotësim–ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, AK-ja është dashur ta refuzojë tenderin pa kërkuar informacion shtesë të mëtejshëm, sepse kjo është kërkesë administrative. Këtë e përcakton neni 10.1 i udhëzuesit.

Pretendimin ankimor nr. 6:

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 61 “Tenderët jo-normalisht të ulët” të LPP-së dhe neni 41 “Tenderët jo-normalisht të ulët” të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

OE-ja i rekomanduar për kontratë ka, në FDT, Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, vendosur çmime të paarsyeshme. Duke u bazuar në dosjen e tenderit, ne si kompani, para dorëzimit të ofertave–tenderit, kemi marrë ofertën e çmimeve për automjetet e cekura te Pjesa 1 nga Porsche Prishtina. Automjetet janë të prodhuesit Volkswagen, viti i prodhimit 2020–2025, dhe në FTD ka qenë kriter i qartë se pjesët duhet të jenë nga prodhuesi.

Oferta jonë financiare e dorëzuar për Pjesën 1 (lloji Skoda Octavia) te Pjesa II, Lista e çmimeve, është ofertuar vetëm sipas kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe që i përgjigjet kërkesave të AK-së në FDT.

OE-ja i rekomanduar për kontratë, për Pjesën 1 – Skoda Octavia, në Pjesën II – Lista e çmimeve, ka vendosur çmime jo-normalisht të ulëta dhe jashtë çdo norme. Me datë 23.09.2025, kur na është lejuar qasja në dokumentet e OE-së së rekomanduar për kontratë, AK-ja nuk na ka prezantuar ndonjë dokument dëshmues apo korrespondencë me OE-në e rekomanduar për kontratë, duke përfshirë emailat ose çdo informacion të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi për tenderin jo-normalisht të ulët, në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

OE-ja i rekomanduar ka vendosur çmime jo-normalisht të ulëta, spekulative dhe jo të besueshme krahasuar me specifikat dhe kushtet e kontratës për Pjesa 1 (Skoda Octavia), Pjesa 2 (Peugeot 308), Pjesa 3 (VW Golf IV Variant TDI) dhe Pjesa 4 (Nissan Patrol).

Me datë 27 maj 2025, AK-ja – Administrata Tatimore e Kosovës, përmes platformës e-prokurimi, ka bërë sqarimin e tenderit me informata për llojet e automjeteve, duke ngarkuar si mostër për tri pjesët numrat e shasisë së automjeteve. Bazuar në këto sqarime, kemi marrë ofertat e çmimeve nga distributorët e autorizuar të prodhuesve.

Në ofertat tona të marra nga përfaqësuesit e autorizuar të prodhuesve për Pjesën 1: Skoda Octavia (Porsche Prishtina, Baki Automobile), janë të shënuar edhe numrat e shasisë.

Për Pjesën 1: Skoda Octavia, OE-ja i rekomanduar ka vendosur çmime jo-normalisht të ulëta dhe spekulative në shumicën e pozicioneve, te emërtimi i pjesëve apo shërbimeve, ku disa prej pjesëve kryesore janë me çmime jashtë çdo norme.

Çmimet nga përfaqësuesit e autorizuar të prodhuesve për Pjesën 1; Skoda Octavia, nga Porsche Prishtina, Baki Automobile. (Prova dhe dëshmi bashkëngjitur gjeni ofertat nga Porsche Prishtina, Baki Automobile për çmimet e automjeteve Skoda Octavia të tregut). Gjithashtu, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur edhe çmime të tjera jo-normalisht të ulëta, çmime jo të besueshme, çmime spekulative dhe çmime jo të tregut për Pjesën 1: lloji i automjeteve Skoda Octavia te emërtimi i pjesëve për këto pozicione si më poshtë. Të gjitha këto pozicione artikujsh janë me çmime normalisht të ulëta nga OE-ja i rekomanduar për kontratë, të cilat i ka vendosur për Pjesën 1: lloji i automjeteve Skoda Octavia te Pjesa II, Lista e çmimeve. Në FDT, Aneksi 1, AK-ja ka kërkuar që pjesët që ndërrohen të jenë origjinale, të reja, të paketuara, të ambalazhuara nga prodhuesi, por me çmimet e vendosura nga OE-ja i rekomanduar për kontratë, ku kemi çmime normalisht të ulëta, çmime spekulative dhe çmime manipulative, çmimet janë 2000% më të lira se çmimet e tregut, ku automjetet janë viti i prodhimit 2023 dhe 2025. AK-ja në dosjen e tenderit kërkon kërkesa specifike ku thekson se pjesët që ndërrohen kërkohet të jenë origjinale, të reja, të paketuara, të ambalazhuara nga prodhuesi dhe AK-ja ka kërkuar që të gjitha pjesët të jenë nga prodhuesi. Por me çmimet e vendosura nga OE-ja i rekomanduar për kontratë, nuk ka

mundësi të jenë pjesët nga prodhuesi as të reja. Nuk ka asnjë bazë logjike që pjesa e automjetit Alternatori, në vlerë prej 1,073.00 euro në treg, të vendoset nga OE-ja i rekomanduar për kontratë në vlerë prej 11.99 euro, ku automjetet janë viti i prodhimit 2024. Operatori Ekonomik (OE) i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime jo-normalisht të ulëta, çmime jo të besueshme dhe çmime spekulative, çmime jo tregu në krahasim me specifikat dhe kushtet e kontratës për Pjesën 2: (lloji: Peugeot 308). Me datën 27 maj 2025, AK-ja Administrata Tatimore e Kosovës, përmes Platformës e-prokurimi https://e-prokurimi.rks-gov.netbën sqarimin e tenderit me informata sqaruese për llojet e automjeteve, ku për tri pjesët–llotot si mostër për automjetet ngarkon në sistem me sqarim numrin e shasisë; në bazë të sqarimit nga AK-ja dhe me numrin e shasisë së automjeteve ne kemi marrë ofertat e çmimeve nga distributorët e autorizuar të prodhuesve. Sqarimi për disa pjesë për Pjesën 2: lloji Peugeot 308 është bërë duke e pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në FDT nga ana e AK-së. Në PRO-FATURËN tonë, të cilën e kemi marrë nga përfaqësuesit e autorizuar të prodhuesve për Pjesën 2: llojin e automjeteve Peugeot 308 nga Mervom Company, në ofertë janë të shënuar edhe numrat e shasisë së automjeteve të AK-së Administrata Tatimore e Kosovës. Për Pjesën 2: lloji Peugeot 308, OE-ja i rekomanduar ka vendosur çmime normalisht të ulëta dhe çmime spekulative në shumicën e pozicioneve, te emërtimi i pjesëve apo shërbimeve, ku disa nga pjesët kryesore janë me çmime jashtë çdo normales. (Bashkëngjitur gjeni dëshminë–proven, ofertat nga distributori i autorizuar i prodhuesit për automjetin Mervom Company; dallimi nga çmimet e prodhuesit dhe nga OE-ja i rekomanduar për kontratë është 2000%). Gjithashtu, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur edhe çmime të tjera jo-normalisht të ulëta, çmime jo të besueshme, çmime spekulative dhe çmime jo tregu për Pjesën 3: lloji i automjeteve VW Golf IV te emërtimi i pjesëve për këto pozicione si më poshtë. (Bashkëngjitur gjeni dëshminë–proven, ofertat nga auto pjesët për çmimet, dhe dallimi nga çmimet e OE-së të rekomanduar për kontratë është shumë i madh). 139 pozicione të Pjesës 3: lloji i automjeteve VW Golf IV në specifikacionin teknik dhe në ofertën financiare te Pjesa II, Lista e çmimeve, janë pozicione me çmime normalisht të ulëta, çmime jo të besueshme, çmime spekulative dhe çmime jo tregu, që nuk kanë asnjë bazë të jenë çmime të tregut. Në asnjë rrethanë OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk mund t'i sqarojë apo gjatë ekzekutimit të kontratës t'i sigurojë. Po ashtu, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur edhe çmime jo-normalisht të ulëta, çmime jo të besueshme, çmime spekulative dhe çmime jo tregu për Pjesën 4: lloji i automjeteve Nissan Patrol te emërtimi i pjesëve për këto pozicione si më poshtë. 50 pozicione të Pjesës 4: lloji i automjeteve Nissan Patrol te specifikacioni teknik në ofertën financiare te Pjesa II, Lista e çmimeve, janë pozicione me çmime normalisht të ulëta, çmime jo të besueshme, çmime spekulative dhe çmime jo tregu, që nuk kanë asnjë bazë të jenë çmime të tregut. Në asnjë rrethanë OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk mund t'i sqarojë apo gjatë ekzekutimit të kontratës t'i sigurojë.

Pretendimin ankimor nr. 7:

Autoriteti Kontraktues (AK) Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 20.05.2025, përmes Platformës e-prokurimi https://e-prokurimi.rks-gov.net ka bërë publik Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së" (tenderi është i ndarë në 4 pjesë), me nr. prokurimit: 11600-25-4483-2-1-1, nr. i brendshëm i prokurimit: 11600-25-014-2-1-1. AK-ja ka inicuar Kontratë Publike Kornizë–Shërbime për nevojat e AK-së; tenderi ka qenë i ndarë sipas Udhëzuesit nr. 002/2024 për plotësim–ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurimin publik, se si aplikohet çmimi për njësi i peshuar me poentim, në kategori: Nëntotali 1: çmimi për servisime të rregullta dhe pjesë mekanike; Nëntotali 2: çmimi për pjesët mekanike dhe elektrike; Nëntotali 3: çmimi për riparimin e pjesëve të limarisë dhe ngjyrosje; Nëntotali 4: çmimi për riparimin e pjesëve

mekanike dhe elektrike. OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime abuzive, çmime spekulative, çmime manipuluese. Te Pjesa II, Lista e çmimeve, për Pjesën 1: (lloji Skoda Octavia), OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime absurde për riparime të pjesëve. Te oferta financiare te Pjesa II, Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë Pjesën e re Alternatorin e ka vendosur me çmim prej 11.99 euro, ndërsa për riparimin e alternatorit ka vendosur çmim prej 150.00 euro; dhjetë herë më shumë AK-së do t'i kushtojë riparimi i alternatorit se sa Alternatori i ri. Pjesën "Instrument tabela" e ka vendosur me çmim prej 59.99 euro, ndërsa për riparimin e pjesës "Instrument tabela" ka vendosur çmim prej 299.00 euro. Dëshmi – Për Pjesën 1: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji Skoda Octavia) sipas kërkesave të AK-së. Te Pjesa II, Lista e çmimeve, për Pjesën 2: (lloji Peugeot), OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime absurde për riparime të pjesëve. Te oferta financiare te Pjesa II, Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë Pjesën Alternatorin e ka vendosur me çmim prej 59.00 euro, ndërsa për riparimin e alternatorit ka vendosur çmim prej 150.00 euro; Pjesën "Instrument tabela" e ka vendosur me çmim prej 69.00 euro, ndërsa për riparimin e pjesës "Instrument tabela" ka vendosur çmim prej 299.00 euro, dhe shumicën e pozicioneve i ka vendosur me këto çmime manipuluese. Dëshmi – Për Pjesën 2: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji Peugeot) sipas kërkesave të AK-së. Gjithashtu, të njëjtat çmime i ka vendosur edhe për Pjesën 4: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji Nissan Patrol). Dëshmi – Për Pjesën 4: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji Nissan Patrol) sipas kërkesave të AK-së. Gjatë ekzekutimit të kontratës mes AK-së – Administratës Tatimore të Kosovës dhe OE-ve për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, AK-ja ka pasur opinion dhe rekomandim nga Zyra Kombëtare e Auditimit për këtë dukuri, ku ne jemi njoftuar nga menaxheri i kontratës z. Sopi gjatë ekzekutimit të kontratës. AK-së për 36 muaj gjatë ekzekutimit të kontratës, më shtrenjtë do t'i bëhen riparimet se sa ndërrimet e pjesëve. Është jashtë çdo logjike të shëndoshë që një riparim të kushtojë dhjetë herë më shtrenjtë se pjesa e re. AK-ja në këtë rast nuk e ka zbatuar nenin 1 (Qëllimi) të LPP-së, ku citohet: "Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë…" dhe nuk e ka pasur parasysh as nenin 6 të LPP-së ku thuhet: "Të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit…".

Pretendimin ankimor nr. 8:

Autoriteti Kontraktues – AK-ja e Administratës Tatimore të Kosovës, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, nuk e ka respektuar nenin 4 "Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit" të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Te Pjesa 1: lloji Skoda Octavia, në ofertën financiare te Pjesa II, Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime jashtë çdo parashikimi, çmime absurde për njësi–copë: te Pjesa 1 Skoda Octavia, pozicioni nr. 249 "Ventill dalës" 195.00 euro për copë; pozicioni nr. 250 "Ventill thithës" 199.00 euro për copë. Te Pjesa 2: lloji Peugeot, te Pjesa II, Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar ka vendosur çmime jashtë çdo parashikimi, pozicioni nr. 249 "Ventill dalës" 195.00 euro për copë, pozicioni nr. 250 "Ventill thithës" 199.00 euro për copë. Te Pjesa 3: lloji VW Golf IV, të njëjtat çmime absurde: pozicioni nr. 249 "Ventill dalës" 95.00 euro për copë; pozicioni nr. 250 "Ventill thithës" 97.00 euro për copë. Te Pjesa 4: lloji Nissan Patrol, pozicioni nr. 249 "Ventill dalës" 195.00 euro për copë; pozicioni nr. 250 "Ventill thithës" 199.00 euro për copë. Automjetet që posedon AK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) kanë nga 8 copë ventill dalës dhe 8 copë ventill thithës. 16 x 195 = 3,120.00 euro vetëm ventillat e automjeteve Skoda

Octavia. Te Pjesa 3: lloji VW Golf IV te Pjesa II, Lista e çmimeve, OE-ja ka vendosur: • Pozicion nr. 249: Ventill dalës 95.00 x 16 = 1,520.00 euro; • Pozicion nr. 250: Ventill thithës 97.00 x 16 = 1,552.00 euro; • Totali: 3,042.00 euro vetëm ventillat. Këto çmime janë absurde; këto çmime AK-ja mund t'i verifikojë edhe nga OE tjetër pjesëmarrës, kompania "Reforma" SH.P.K., e cila është distributor dhe i autorizuar gjeneral nga prodhuesi Volkswagen.

Pretendimin ankimor nr. 9:

Lidhur me OE-në pjesëmarrës Bastri Ademi B.I., me datë 23.09.2025 na është lejuar qasja në dokumentacionin e operatorit ekonomik Bastri Ademi B.I.; kemi kërkuar sigurimin e tenderit. AK-ja, si dëshmi, na ka ofruar faturën e sigurimit të ofertës së dorëzuar me nr. 30062025-10001226894. Bazuar në këto dëshmi qëndron eliminimi i AK-së i cekur në vendimin B58 të datës 22.09.2025, pasi OE-ja nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit. Bazuar në Udhëzuesin nr. 002/2024 për plotësim–ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurimin publik, kur mungon sigurimi i tenderit refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm; 28/3 është kusht administrativ. Por duhet të kemi parasysh se edhe po ta dorëzonte ky OE sigurimin e tenderit, përsëri do të ishte i papërgjegjshëm. OE-ja Bastri Ademi B.I. është një kompani e cila bën mashtrime në prokurimin publik; pothuajse shumica e AK-ve në Republikën e Kosovës janë duke e diskualifikuar nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit. Po t'i vlerësonit ofertat e këtij OE-je, i njëjti do të rezultonte se ka dorëzuar ofertë duke ju mashtruar në prokurim publik.

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit të procedurës së prokurimit në përgjithësi nuk ka luajtur rol aktiv për të siguruar që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Kjo ka ardhur për shkak të mosrespektimit objektiv të kërkesave dhe kritereve të parapara në njoftim dhe në dosjen e tenderit. Më saktësisht, AK-ja pa të drejtë ka shpërblyer me kontratë një OE i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes dhe ka vendosur çmime manipuluese. Nga kjo shihet se AK-ja po tenton të shpërblejë me kontratë një operator ekonomik që është plotësisht i papërgjegjshëm dhe rrezikon dështimin e implementimit të kontratës. Po ashtu, AK-ja ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi gjatë procesit të vlerësimit nuk i ka trajtuar tenderuesit në mënyrë të barabartë. Edhe pse operatori i shpallur fitues kishte mangësi të mëdha në ofertë, ndërsa ne i plotësojmë të gjitha kriteret, jemi diskriminuar.

Operatori i rekomanduar nuk posedon dëshmi të rregullta për mjetet, pajisjet dhe hapësirën prej 250 m² të objektit të servisit. Hapësira prej 250 m² përfshin dy pjesë të objektit të servisit, depo, zyrë. I njëjti OE ka vendosur çmime manipulative; OE në fjalë nuk është aspak i përgjegjshëm për këtë projekt, megjithatë është shpërblyer me kontratë.

Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi nuk i ka zbatuar drejt kërkesat e dosjes. Ky nen përcakton se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e dosjes dhe njoftimit. Veprimi i AK-së dhe i komisionit të vlerësimit përbën shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së, si dhe të dispozitave për vlerësimin dhe krahasimin e drejtë të tenderëve.

AK-ja ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi nuk ka zbatuar kriteret e vendosura sipas nenit 69.4 dhe 69.4.1; shumicën e kritereve i ka anashkaluar te vlerësimi i OE-së fitues, duke favorizuar atë dhe duke diskriminuar kompaninë tonë.

Bazuar në faktet e lartcekura, shihet qartë se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm dhe është dashur të skualifikohej nga AK-ja. OE nuk ka ofertuar në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe

duhet të shpallej i papërgjegjshëm. Ne konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 40 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, as me nenin 41 për tenderët jonormalisht të ulët, paragrafët 41.6, 41.8, 41.9, 41.10. Nuk është respektuar kriteri kryesor i dhënies së kontratës, tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertës sonë nuk është bërë në bazë të LPP-së dhe si rezultat ne jemi diskriminuar si operator që kemi dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët për njësi të peshuar.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Me datë 26 Shtator 2025, është pranuar nga Autoriteti Kontraktues kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga operatori ekonomik “Gani Krasniqi B.I.” për aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së” (tenderi është i ndarë në 4 pjesë), me nr. të brendshëm të prokurimit 11600-25-014-211, me nr. e-prokurimi 11600-25-4483-2-1-1; Pjesa 1: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji: Skoda Octavia) sipas kërkesave të AK-së; Pjesa 2: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji: Peugeot 308) sipas kërkesave të AK-së; Pjesa 3: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji: VW Golf IV variant, TDI) sipas kërkesave të AK-së; Pjesa 4: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji: Nissan Patrol) sipas kërkesave të AK-së.

Sipas OE, dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues janë:

Neni 1 i LPP-së Qëllimi; Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi; Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; Neni 61 i LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët; Neni 60 i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës; Neni 69 i LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

Dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, në tekstin e mëtejmë do t’i referohemi si RRPP: Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit; Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, paragrafët 41.6, 41.8, 41.9, 41.10. UDHËZUESI NR. 002/2024 për plotësim–ndryshimin e Udhëzuesit NR. 001/2023 për Prokurimin Publik, Neni 10.1 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Me datë 26 Shtator 2025, është pranuar nga Autoriteti Kontraktues kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga operatori ekonomik "Bastri Ademi B.I." për aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së” (tenderi është i ndarë në 4 pjesë), me nr. të brendshëm të prokurimit 11600-25-014-211, me nr. e-prokurimi 11600-25-4483-2-1-1; Pjesa 1: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji: Skoda Octavia) sipas kërkesave të AK-së; Pjesa 2: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare (lloji: Peugeot 308) sipas kërkesave të AK-së.

Sipas OE, dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues janë:

Neni 1 Qëllimi; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi; Neni 59 i LPP-së; Neni 57 i LPP-së.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim “Gani Krasniqi B.I.”, Autoriteti Kontraktues pas trajtimit të këtyre pretendimeve vlerëson se pretendimet janë të paqëndrueshme, të pabazuara në rregullat ligjore të prokurimit publik.

Fillimisht njoftohet OE “Gani Krasniqi B.I.” se sa i përket shpenzimit të parasë publike në mënyrë efikase, efektive, ekonomike dhe të drejtë, AK për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë koston vjetore të servisimit dhe mirëmbajtjes së veturave zyrtare në vlerën mesatare për një veturë 809.97 €, me kosto mesatare mujore të servisimit për një veturë 67.49 €. Kostoja është nxjerrë nga vlera e parashikuar totale e servisimeve të veturave që është 275,000.00 €, në krahasim me sasinë prej 126 veturave, që është kosto e arsyeshme ekonomike për servisim dhe mirëmbajtje të veturave zyrtare në raport me shpenzimin e parasë publike.

Shtuar kësaj, kostoja për 126 vetura të marra me qira me një kosto mesatare mujore prej 367.00 €, që në total për tri vite kap vlerën 1,664,712.00 €, tregon se kostoja e mirëmbajtjes së veturave ka kosto më të ulët në vlerën prej 1,389,712.00 €. Pra, qëllimi i AK-së është të servisojë dhe mirëmbajë veturat me kosto shumë të arsyeshme.

Lidhur me pretendimin ankimor mbi supozimin e OE për listën e kontratave, OE i propozuar për dhënie të kontratës ka plotësuar këtë kriter sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për të cilën ka ofruar referenca që tejkalojnë bindshëm vlerën e kërkuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE për hapësirën e objektit të servisit, kërkohet të jetë minimum 250 m2 me dokumentacion përkatës zyrtar. OE i propozuar për dhënie të kontratës ka plotësuar këtë kriter sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për të cilën ka ofruar dokumentacion përkatës zyrtar të lëshuar nga Komuna e Prishtinës lidhur me hapësirën dhe obligimet që kryen ndaj komunës, përfshirë edhe lejen e ndërtimit sipas rregullave ligjore të aplikueshme, derisa nga OE “Gani Krasniqi B.I.” nuk kemi mundur të shohim që ka dorëzuar lejen e ndërtimit për objektin e servisit. OE i propozuar për dhënie të kontratës ka plotësuar këtë kriter sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, derisa pretendimi i rrejshëm i OE “Gani Krasniqi B.I.” do të trajtohet sipas rregullave të prokurimit publik.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE për disponimin e mjeteve apo pajisjeve teknike, OE i propozuar për dhënie të kontratës ka plotësuar këtë kriter sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Madje, për nga hapësira dhe kapaciteti teknik, OE i propozuar për dhënie të kontratës është dukshëm e bindshëm më i mirë se OE që ka bërë kërkesën për rishqyrtim dhe kjo në dukje të servisit shihet.

Lidhur me pretendimin ankimor mbi supozimin e OE për automjetin për bartjen e automjeteve, OE i propozuar për dhënie të kontratës ka plotësuar këtë kriter sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ku kjo mund të shihet edhe në pretendimin me supozim.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE për deklaratën për mallrat dhe shërbimet e ofruara, OE i propozuar për dhënie të kontratës ka plotësuar këtë kriter sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ku deklaratat janë nënshkruar dhe vulosur, ndërsa kjo deklaratë është dorëzuar e nënshkruar, që është konsideruar devijim i vogël pa asnjë përmbajtje apo devijim material në asnjë aspekt që mund të ketë për këtë aktivitet.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE për tenderët jo-normalisht të ulët, AK ka kërkuar sqarime nga OE me datën 9 Shtator 2025 përmes platformës e-prokurimi, ku OE i propozuar për dhënie të kontratës ka kthyer përgjigje përmes platformës duke arsyetuar ofertën e dorëzuar sa i përket çmimeve dhe bazës ligjore, duke shënuar edhe një aktivitet të ushtruar në emër të AK-ve nga një AK, ku është shpërblyer me 8 pjesë. Për këtë ka pasur një metodë dhe metodologji vlerësimi të specifikuar në dosjen e tenderit, ku në të gjitha AK-të aplikohet kjo metodë e vlerësimit; nuk

mund të ketë metodë vlerësimi me selektim të disa pozicioneve, por oferta vlerësohet në tërësi, duke respektuar kriterin e dosjes së tenderit. Për më tepër, OE i propozuar për dhënie të kontratës sa i përket kapacitetit teknik është bindshëm më i mirë se OE që ka bërë kërkesën për rishqyrtim.

Po ashtu, vlen të ceket se OE i propozuar për dhënie të kontratës ka dorëzuar deklaratat tatimore vjetore për vitet 2022, 2023, 2024 siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, ndërsa OE "Gani Krasniqi B.I." ka dorëzuar vetëm deklaratën tatimore vjetore për vitin 2024, ku shihet për vitin 2024 se edhe në pagesën e tatimit në të ardhurat personale në buxhetin e shtetit është me vlerë më të vogël, po ashtu edhe në përqindje dhe shumëfish me vlerë më të vogël në pagesën e tatimit në të ardhurat personale në krahasim me qarkullimin. Kjo shpreh se AK ka bërë zgjedhjen më të mirë të mundshme të ofertës në krahasim me ofertën e OE të kërkesës për rishqyrtim "Gani Krasniqi B.I.".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim "Bastri Ademi B.I.", Autoriteti Kontraktues pas trajtimit të këtyre pretendimeve vlerëson se pretendimet janë të paqëndrueshme, të pabazuara në rregullat ligjore të prokurimit publik.

Oferta e OE "Bastri Ademi B.I." është vlerësuar e papërgjegjshme në aspektin administrativ për arsye se me dorëzimin e ofertës me datën 30.06.2025 ora 10:39 AM, nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit për Pjesën 1, Pjesën 2, Pjesën 3 dhe Pjesën 4 siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Sipas nenit 57.2, 59.4 të LPP-së, nenit 28.7 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 10 të Udhëzuesit nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, mosdorëzimi i sigurisë së tenderit do të rezultojë me refuzimin e tenderit (fatura nuk është sigurim i tenderit), dhe është vlerësuar tender i papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesve të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues konsideron se parashtruesit e ankesës për rishqyrtim nuk kanë dorëzuar argumente për pretendimet e tyre qoftë mbi bazën faktike apo ligjore, dhe si të tilla nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara. AK konsideron se ka respektuar dispozitat ligjore të nenit 1, nenit 7, nenit 6, nenit 59, nenit 60, nenit 61, nenit 69 të LPP-së, siç është specifikuar dhe arsyetuar mbi bazën faktike dhe ligjore në pikën 3 dhe pikën 4 të këtij vendimi.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe rrjedhimisht është propozuar për dhënie të kontratës OE që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët me poentim sipas kriterit për dhënie të kontratës të specifikuar në dosjen e tenderit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.10.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0992, ndërsa me datë 14.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0992. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEGani B. Krasniqi B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0992, ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Administrata Tatimore e Kosovës, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës shërbime, vlera e parashikuar për katër lotet 275,000.00€.

AK me dt 21.05.2025 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt 02.07.2025 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar vetëm 14 operator ekonomik ë të gjitha lotet në mesin e tyre edhe OE ankues.

AK- Administrata Tatimore e Kosovës me dt. 22.09.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se ku për kontratë ka rekomanduar Mirsad Gashi B.I) për të gjitha lotet/pjesët. Ndërsa oferten e OE ankues, AK e ka vlerësuar si ofertë të përgjegjshme por e pasukseshme.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt 26.09.2029 brenda afatit ligjor. AK me dt. 06.10.2025 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pa-bazuar. Ndërsa pika III e vendimit të AK-se është në kundërshtim me raportin e vlerësimit, Njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe letrat standarte, kjo për faktin se komisioni i vlerësimit ofertën e OE ankues e ka vlerësuar si të përgjegjshme por e pasukseshme ndërsa pika III e vendimit parasheh që; Dokumenti i datës 13.06.2025 nr.2025004532/1 i dorëzuar nga OE ankues dhe pranuar nga AK, që përmbanë emrin e ATK-se, adresën e ATK-se, nr. Fiskal të ATK-së, ky dokument do të trajtohet në kuadër të deklaratës së rrejshme nën betim të nënshkruar nga OE për dorëzimin e çfardo dokumenti, aq më tepër pranimin dhe dorëzimin e një dokumneti në emër të ATK-së, pa pasur të drejtën dhe autroizimin për të përdorur dokumnetin. Po ashtu do të trajtohen edhe nënshkrimet e deklaratës nën betim dhe të kërkesës për ri-shqyrtim. Eksperti shqyrtues sqaron se, një arsyetim i tillë në vendim është befasues dhe në kundërshtim të plotë me raportin e komisionit të vlerësimit dhe nenin 26 pika 14 e rregullores për prokurimin publik RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK *"Nëse Autoriteti kontraktues zbulon se një anëtar i grupit të operatorëve ekonomik ka ofruar të dhëna të rreme apo dokument të falsifikuar, Autoriteti kontraktues do të eliminojë tenderin e grupit të OE ndërsa ndaj anëtarit të grupit që ka ofruar informatë të rreme apo dokument të falsifikuar, do të veprojë në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së"*. Eksperti shqyrtues sqaron se në rastin konkret AK, respketivisht komisioni i vlerësimit ofertën e OE ankues e ka vlerësuar si të përgjegjshm/pasukseshme ndërsa në pikën II

të vendimin për refuzimin e kërkeses për ri-shqyrtim ka vlerësuar se dokumenti i lartëcekur është i rrejshëm. Në një situatë të tillë, vlerësoj se AK konform nenit 26 pika 14 e rregullores së lartcekur, është dashur që ofertën e OE ankues ta ekiminoj dhe ta trajtoj konform nenit 99.2 të LPP-se e jo ta vlerësoj si të pasukseshme. OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt. 07.10.2025 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës në kërkesën për Ri-shqyrtim dhe ankesën e dorëzuar në OSHP, në pretendimet e tij, kundërshton ofertën e OE të rekomanduar për kontratë tek kërkesa e dosjes së tenderit të vendosuar tek kapaciteti teknik dhe profesional apo 9&1 dhe 9&2 saktësisht kërkesat 1,3,4,5 dhe 6 poashtu edhe çmimet e disa pozicioneve të parapara tek specifikacioni teknik/përshkrimi i çmimit me arsyetim se ka ofertuar me cmimi jo-normalisht të ulëta. Bazuar në pretendimet ankimore të OE ankues, Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesat e parapara tek kapaciteti teknik dhe profesional apo 9&1 dhe 9&2 dhe poashtu ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive AK në dosje të tenderit për pretendimin e parë të OE ankues, kishte kërkuar listën e kontratave për servisimet e veturave te realizuara në 3 vitet e shkuara duke saktësuar shërbimin, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit. Vlenë të ceket fakti se AK në këtë kërkesë nuk kishte cekur vlerën minimale të kontratave të realizuara si parakusht për tu konsideruar një OE i përgjegjshëm, këtë AK e kishte bërë tek dëshmia apo evidenca 1 mirpo ishte shumë e paqartë si kërkese sepse nuk ishte specifikuar qartë vlera për secilin lot/pjesë dhe sa është vlera totale për të gjitha lotet/pjesët që OE duhet të kishte kontrata të realizuar për tu vlerësuar i përgjegjshëm pë të gjitha lotet/pjesë. Për qëllime të ekspertizës do të mundohemi ti zbërthejm shifrat të cilat AK i ka specifikuar tek evidenca1 duke u bazuar edhe në vlerën e pretenduar nga OE anukues.

<u>Kërkesa 1</u>: Listën me të cilën specifikohen kontrata ose kontratat për servisimet e veturave të operatorit ekonomik të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar shërbimet, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

<u>Evidenca 1:</u> Operatori ekonomik duhet te plotësoj listën e kontratave për servisimet të veturave, që është formulari i dhënë në Aneksin 8 te dosjes së tenderit, dhe të bashkangjet si dëshmi reference ose referencat ose kur është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e faturës të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë, kërkohet në vlerën 130,000.00 euro për pjesën 1, pjesën 2; ndërsa kërkohet në vlerën 50,000.00 euro për pjesën 3, pjesën 4. Në rast se ofertuesit ofertojnë si konzorcium nga lideri i grupit të OE kërkohet të ketë së paku 70% të vlerës së references/ave për servisim të automjeteve.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në kërkesen e dosjes së tenderit, askund nuk është përcaktuar vlera minimale për vetëm një lot/pjesë psh; nëse OE oferton vetëm në lot/pjesën "dy: sa duhet të jetë qarkullimi minimal i kontratave te realizuara për atë pjesë dhe njëkohësisht sa do të jetë 70% në rast se ofertojnë si grupi i OE-ve vetëm në pjesën/lotin 2. Lidhur me këtë në rastin konkret po i referohemi pretendimit ankimor me numër 1 të OE ankues, përmes të cilit pretendon se OE ankues nuk e përmbush kërkesën e dosjes;

*"Duke u bazuar ne OE-në e rekomanduar për kontratë Mirsad Gashi B.I., dhe marre parasyshe se jemi konkurent me OE-në në Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe marrim pjesë ne aktivitete e njejta te prokurimit për servisime dhe mirëmbajtje te automjeteve supozojem se ky OE nuk posedone referenca te për pune te kryera në vlere prej **180,000.00 Euro**, në tri vitet e shkuara, siq është kërkuar në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Po ashtu duke e pasure parasyshe edhe kërkesën për konfidencialitet te nenint 68 dhe 69, është argument që te jepe me kuptu se OE-ja nuk e plotsone këtë kerkesë te para para ne NJF dhe DT".*

Për ta trajtuar këtë pretendim ankimor, kemi analizuar me kujdes oferten e OE të rekoanduar për kontratë, ku në filen e emertuar si **"1. Aneksi 2 Deklarata nen betim dhe deklaratat tjera"** OE i rekomanduar për kontratë në faqen e tretë ka bashkangjitur të plotësuar aneksin 8 apo listën e kontratave të realizuara. Në listën e bashkangjitur, vërehet se OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur gjithësej 5 kontrata për servisimin e automjeteve me AK të ndryshme në vlerë totale prej 653,009.04€. Dëshmitë për projektet e listës i ka bashkangjitur tek file i emertuar si; **"3.Referencat 3 vitet e fundit Miri**", në kuadër të këtij file janë; 1. Referenca e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, me dt 23.09.2022 për aktivitetin e prokurimit me titull; Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MPB-se, përmes të cilës vërtetohet se OE i rekomanduar ka realizuar kontratën në vlerën e parashikuar prej **150,000.00€,** Referenca e lëshuar me dt 07.10.2024 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infastrukturës, për aktivitetin e prokurimit me titull; Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare MEA lot1 dhe Lot 2 në vlerë prej **229,000.00€;** Referenca e lëshuar me dt 14.03.2025 nga Administrata Tatimore, përmes të cilës vertetohet se OE i rekomanduar për kontratë ka realizuar, servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve sipas pjesëve, ku pjesa e pare është realizuar në vlerë prej **54,014.74€** pjesa e tretë është realizuar në vlerë prej **48,419.55€** pjesa e pestë është realizuar në vlerë prej **27,505.44€** dhe pjesa e gjashtë është realizuar në vlerë prej **1,291.81€.**

Eksperti shqyrtues sqaron se, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi të mjaftueshme përmes të cilave dëshmohet se i njejti ka realizuar kontrata për servisimin e automjeteve në tri vitet e fundit në vlerë totale prej 653.009.04€ dhe në rastin konkret e plotëson kërkesen e AK-së ashtu siç është formuluar në dosje të tenderit dhe njëkohësisht tejkalon vlerën prej 180,000.00€ të pretenduar nga OE ankues se OE i rekomanduar nuk e përmbushë kërkesen e dosjes së tenderit sa i përketë kontratave të realizuara në tri vitet e fundit. ***Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i parë i palës në ankesë është i pabazuar.***

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor, Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte aplikuar kërkesën me numër tre si vijon; **Kërkesa 3:** Hapësira e objektit të servisit kërkohet të jetë minimum 250 m^2 me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë: reshjet, era, pluhuri. Hapësira e objektit të servisit, duhet të jetë larg në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë: Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë. (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Evidenca 3: *Hapësira e objektit të servisit, të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Hapësira e objektit të servisit, të dëshmohet me dëshmi me shkrim mbi vendndodhjen dhe largësin e servisit në rrugë tokësore maksimumi deri*

15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë, Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk posedon hapsirë prej 250 $m^{2,}$ sepse objekti përfshinë vetëm dy pjesë për servisim dhe atë 8x10=80m2, dhe 8x10=80m2, ku gjthsej bijen 160 m^2 hapësire e objektiti për servisim te automjeteve. Një pjesë të objektiti e posedon depo për autopjesë, ku besoje dëshmohet edhe me foto te prezentuara nga vete OE-ja. Dhe nga i njejti objekt është një pjesë zyre, dhe kafe e cila sherben për nevojat e OE-së.

Për ta përmbushur këtë pikë, OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar **"4. Hapësira e objektit-servisit me dokumentacion zyrtar**" në kuadër të këtij file ka bashkangjitur disa dokumente si në vijim; 1. Planimetria, Aktvendimi ne 01-980 i lëshuar nga Komuna e Prishtinës,për ndërtim të *objektit të përkohshëm montazh* për servisimin e automjeteve P+0 tek vendi Bërnicë e Epërme; 2, Certifikaten nga Njësia Kadastrale te datës 03.06.2013 vendi i quajtur mbi rrugë, bashkëpronar me nga ½ Sabit Gashi dhe Mirsad Gashi, lloji i parcelë arë e klasës së tretë me sipërfaqe 813 m^2; 3. Faturën e Tatimit në pronë të lëshuar nga Komuna e Prishtinës dt 06.01.2018, në emër të Mirsad Sabit Gashi- Auto servisi MIRI, në të cilë sipërfaqja është 250 m^2 ndërsa kategoria e pronës për afarizëm; 4 Fatura e tatimit në pronë nga Komuna e Prishtinës e lëshuar me dt.07.01.2024, në këtë faturë nuk ka as sipërfaqe dhe kategori të pronës; 5 Tri vlerësime të pronave në vitin 2023 tek adresa Bërnicë e Epërme.

Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive AK në dosje të tenderit për pretendimin e dytë të OE ankues, kishte kërkuar që "Hapësira e objektit të servisit kërkohet të jetë minimum 250 m^2 me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi" nga dëshmitë e cekura më lartë e kemi të pamundur për të vërtetuar faktin se objekti posedon hapsirën e kërkuar si në dosje të tenderit. Vlerësoj se në rastin konkret AK, respektivisht komisioni i vlerësimit është dashur të kërkoj sqarime konform nenit 59 paragrafi 2 dhe nenit 72 të LPP-se për të vërtetuar se objekti në fjalë ka hapsirë tër servisit prej minimum 250m^2 me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi. *Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i dytë i palës në ankesë është pjesërisht i bazuar.*

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor, Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte aplikuar kërkesën me numër katër si vijon: **Kërkesa 4:** Dëshmi mbi disponimin e mjeteve apo pajisjet teknike në dispozicion: Vinç hidraulik për ngritjen e automjeteve – së paku 4 (katër) vinça; Pajisje speciale (kompjuteristike) për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve – së paku 1 (një); Pajisje për vullkanizim dhe balansim të gomave – së paku 1(një); Pajisje për mbushjen e klimave të automjeteve – së paku 1 (një). (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Evidenca 4: *Paisjet e kërkuara të dëshmohen me faturë, foto, ose dokumentacion tjetër dëshmues mbi pronësinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).*

Për ta përmbushur kërkesën OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar: ***"5.Pajisjet_Kapacitetet teknike-me foto, marrveshje e libreza"*** në kuadër të këtij file ka ngarkuar disa fotografi si vijon; 1. Fotografia e objektit me një veturë te tipit audi A4; fotografi të disa rafteve me pjesë të reja, si filtera,rripa dhe vaj, fotografi të një laptopi lenovo në veturë, me programin e hapur VCDS, fotografi të pajisjeve për heqjen e gomave dhe balancimin e tyre; fotografi ku vërehen 4 vinça; fotografi ku shihet aparati për mbushjen e klimave; fotografi ku shihet parkingu i objektit; fotografi me përshkrimin regllazha; fotografi me përshkrimin

pajisje per centrimin e dritave. Eksperti shqyrtues sqaron se, në rastin konkret OE i rekomanduar ka ofruar vetëm fotografi dhe jo dokumente tjera që vërtetojnë pronësinë. Duhet cekur faktin se nga përshkrimi i kërkesës ne dosje të tenderit si dëshmi është kërkuar faturë, foto ose dokumnetacion tjetër dëshmues. Andaj mbetet në përgjegjësi të AK respektivisht komisionit të vlerësimit që ka marrë si dëshmi të mirëqena vetëm fotografitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar pa kërkuar sqarime shtesë për faktin se nga fotografitë e dorëzuara me ofertë për disa pajisje nuk mund të vërtetohet se janë në pronësi te Operatorit ekonomik te rekomanduar për kontratë. *Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i tretë i palës në ankesë është pjesërisht i bazuar.*

Lidhur me pretendimin e katërt ankimor, Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte aplikuar kërkesën me numër pesë si vijon: **Kërkesa 5:** Automjet për bartjen – tërheqjen e automjeteve në rast defekti në rrugë. Kërkohet automjeti transportues (kamioni) për tërheqjen e automjeteve te vogla (kërkohet për pjesën 1,

Evidenca 5: *Automjet për bartjen – tërheqjen e automjeteve. Të dëshmohet me fotografi dhe librezë valide të regjistrimit të automjetit (kamionit) në emër të kompanisë ose me kontratë/marrëveshje të marrë me qira (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).*

Për ta përmbushur kërkesën OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar të filen e emërtuar: **"5.Pajisjet_Kapacitetet teknike-me foto"** në kuadër të këtij file në faqen 23 ka dorëzuar marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve për bartjen e automjeteve e lidhur me dt 25.02.2025 në mes te Isa J. Gashi, B.I ofrues i shërbimeve dhe Mirsad Gashi B.I, marrësi i shërbimeve. Objekt i marrëveshjes është kamioni për bartjen e automjeteve i tipit Mercedez-benz me targa 01-685-QG të cilën e posedon ofruesi i shërbimeve, marrëveshja është e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Poashtu si dëshmi shtesë janë bashkangjitur, dy fotografi të kamionit, libreza e regjistrimit dhe certifikata e biznesit të ofruesit të shërbimeve. Eksperti shqyrtues sqaron se, në rastin konkret AK në dosje të tenderit kishte kërkuar që OE të posedoj ose marr me qira një kamion për bartjen e automjeteve. Vlerësoj se komisioni i vlerësimit të ofertave ka vepruar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit kur ka pranuar dëshmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar të cilat përmbushin kërkesën me numër 5. **Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i katërt i palës në ankesë është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e pestë ankimor, Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte aplikuar kërkesën me numër gjashtë si vijon: **Kërkesa 6:** Deklaratë me shkrim për shërbimet, mallrat e ofruara të cilat do të janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Evidenca 6: Të dorëzohet deklaratë me shkrim e **nënshkruar dhe vulosur** nga OE për shërbimet, mallrat e ofruara të cilat do të janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Për ta përmbushur kërkesën OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar të filen e emërtuar: "1. **"Aneksi 2 Deklarata nen betim dhe deklaratat tjera"** në kuadër të këtij file në faqen 5 nga ngarkuar deklaratën për kryerjen e shërbimeve në pajtueshmëri me specifikacionin teknik- listat e çmimeve me ato të përmenduara në aneksin 1 të DT. Eksperti shqyrtues sqaron se, OE i rekomanduar për kontratë kishte ngarkuar disa deklarata të cilat ishin të nënshkruara dhe vulosura, *kurse deklarata e lartëcekur e cila është pjesë e pretendimit ankimor,* ***nuk është e***

vulosur *por vetëm e nënshkruar*. Poashtu bazuar nga dëshmitë e ngarkuara në platëformën elektronike e-prokurimi, AK respektivisht komisioni i vlerësimit nuk kishte kërkuar sqarime shtesë sa i përketë mungesës së vulës, nga këndvështrimi ynë për një kriter të veçantë në dosje të tenderit, ku është kërkuar që te jetë i nënshkruar dhe vulosur, mungesa e vulës e bënë dokumentin jo të plotë dhe njëkohësisht në pa pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit të vendosur nga vet AK. Arsyetimi i dhënë nga AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pabazuar, se mungesa e vulës është devijimi vogël, vlerësoj se është i paqëndrushëm për faktin se aplikimi i një kriteri të tillë si kërkesë e veçantë në dosje të tenderit, ka pasur një rëndësi të veçantë, për aktivitetin e prokurimit në të kundërtën, AK në dosje të tenderit ka pasur specifikacion të qartë dhe njëkohësisht OE kanë nënshkruar deklaratën nën betim, çka nënkupton se është pajtuar me specifikacion teknik. Pra edhe nëse arsyetimi i dhënë nga AK qëndron, atëherë cili ka qenë qëllimi i aplikimit të një kërkesës të veçantë në dosje të tenderit që deklarata e tillë të jetë e nënshkruar dhe vulosur. Eksperti shqyrtues sqaron se mbetet në përgjegjësi të ZPP-së vendosja e kritereve në përputhje me nevojat e AK-se duke shmangur kërkesat e tepërta dhe të panevojshme të cilat sipas arsyshmërisë së AK nuk kanë ndonjë ndikim nëse nuk janë në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. Po ashtu eksperti shqyrtues sqaron se, mbetet në përgjegjësi të komisionit të vlerësimit, që vlerësimin e ofertave ta bëjë në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së duke rekomanduar për kontratë OE i cili përmbushë në tërësi kërkesat e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit. **Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i pestë i palës në ankesë është i bazuar.**

Lidhur me pretendimet ankimore gjashtë/shtatë dhe tetë ankimor, Eksperti Shqyrtues sqaron se, OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta në disa pozicione në lot/pjesë 1, lot/pjesë2, lot/pjesë 4.

Për ta qartësuar këtë pretendim ankimor, me dt 13.10.2025 kam kërkuar sqarime shtesë nga AK, përmes platëformës dhe e-mail. AK ka qenë shumë bashkëpunues dhe përmes e-mail ka dorëzuar të gjitha sqarimet e pranuara nga OE pas kërkesave për sqarime shtesë të dorëzuara nga AK tek OE.

AK, me dt 09.09.2025 përmes platformës eletronike e-prokurimi ka dërguar tek OE i rekomanduar kërkesën për sqarime te tenderit për çmime jo-normalisht të ulëta/larta për lot/pjesën 1, lot/pjesën 2; lot/pjesën 3 dhe lot/pjesën 4 për një numër të madh të pozicioneve. OE i rekomanduar për kontratë me dt. 11.09.2025 ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës së AK-së. Eksperti shqyrtues sqaron se, nga deklarata e ofruar si përgjigje OE i rekomanduar nuk ka bashkangjitur asnjë fakt provë por vetëm një përshkrim madje duke kontestuar edhe bazën ligjore të komisionit të vlerësimit lidhur me kërkesën për sqarime shtesë. Në ekspertizë po i paraqesim vetëm disa pozicione të cilat janë kontestuar nga OE ankues sa i përketë çmimeve maipulative pozicioneve të njëjta me çmime të ndryshme si vijon; Te Pjesa II. Lista e çmimeve, **për Pjesen 1**: (lloji: Skoda Octavia) OE-ja i rekomanduar për kontratë, ka vendosure çmimi apsurde për riparime te pjesve. Te oferta financiare te Pjesa II. Lista e çmimeve. OE-ja i rekomanduar për kontratë Pjesën e re Alternatorin e ka vendosure me çmimi prej **11.99 Euro.** Ndersa për riparimin e alternatorit ka vendosure çmimi prej **150.00 Euro**, dhjete here me shume AK-së do ti kushtoje riparimi i alternatorit, se sa Alternatorit i ri. Pjesën Instrument tabela e ka vendosure me çmimi prej **59.99 Euro.** Ndersa për riparimin e pjesës Instrumentabel ka vendosur me çmimi prej 299.00 Euro. Kurse tek Te Pjesa II. Lista e çmimeve, për Pjesen 2: (lloji: Peugeot) OE-ja i rekomanduar për kontratë, ka vendosure çmimi apsurde për riparime te pjesve. Te oferta financiare te Pjesa II. Lista e çmimeve. OE-ja i rekomanduar për kontratë

Pjesën Alternatorin e ka vendosure me çmimi prej **59.00 Euro.** Ndersa për riparimin e alternatorit ka vendosure çmimi prej **150.00 Euro.** Pjesën Instrument tabela e ka vendosure me çmimi prej **69.00 Euro.** Ndersa për riparimin e pjesës Instrumentabel ka vendosur me çmimi prej **299.00 Euro**, e shumicen e pozicioneve i ka vendosure me këto çmimi manipuluse. Të njetën gjë OE i rekomanduar për kontratë e ka bërë edhe në disa pozicione tjera si; Autoriteti Kontraktues AK-ja Administratës Tatimore te Kosovës, gjate ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, nuk e ka respektuar Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit te Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik. Te Pjesa 1: lloji: Skoda Octavia te oferta financiare te Pjesa II. Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosure çmime jashte cdo parashikimeve, çmime apsurde per njesi- copë. Te pjesa 1 Skoda Octavia, pozicionin me nr: 249. Ventill dalës **195.00 Euro**, për copa, pozicionin me nr: 250. Ventill thithës **199.00 Euro**, për copë. Te Pjesa 2: lloji: Peugeot te oferta financiare te Pjesa II. Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosure çmime jashte cdo parashikimeve, çmime apsurde per njesi. Te pjesa 2 Peugeot, pozicionin me nr: 249. Ventill dalës **195.00 Euro**, për copa, pozicionin me nr: 250. Ventill thithës **199.00 Euro**, për copë. Te Pjesa 3: lloji: VW Golf IV te oferta financiare te Pjesa II. Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosure çmime jashte cdo parashikimeve, çmime apsurde per njesi. Te pjesa 3 VW Golf IV, pozicionin me nr: 249. Ventill dalës **95.00 Euro**, për copa, pozicionin me nr: 250. Ventill thithës **97.00 Euro**, për copë.

Te Pjesa 4: lloji: Nissan Patrol te oferta financiare te Pjesa II. Lista e çmimeve, OE-ja i rekomanduar për kontratë ka vendosure çmime jashte cdo parashikimeve, çmime apsurde per njesi. Te pjesa 4, Nissan Patrol, pozicionin me nr: 249. Ventill dalës **195.00 Euro**, për copa, pozicionin me nr: 250. Ventill thithës **199.00 Euro**, për copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se, AK me dt 09.09.2025 ka kërkuar sqarime shtesë, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar sqarimet me dt. 11.09.2025, vlenë të ceket fakti se OE nuk kishte bashkangjitur asnjë dëshmi apo argument shtesë sa ju përketë çmimeve jo-normalisht të ulëta dhe të larta dhe dallimeve të mëdha në mes të çmimeve siç është rasti alternatorin ka çmimin 11.99€ ndërsa riparimi i alternatorit çminin prej 150.00€. Në rastin konkret, vlerësoj se mbetet në përgjegjësi të komisionit të vlerësimit respektivisht ZPP-së, pranimi apo jo i arsyeve të dhëna pas procedurës së zhvilluar inter/partes në mes AK-se dhe OE të rekomanduar për kontratë. Nga këndvështrimi ynë, një situatë e tillë bie ndesh me nenin 4 paragrafi 1 i RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK për faktin se OE i rekomanduar për kontratë në sqarimet e dërguara nuk ka prezantuar asnjë dëshmi/provë përmes të cilës mund të arsyetohen çmimet e ofruara në ofertën e tij për pozicionet të cilat AK ka kërkuar sqarime për çmime jo-normalisht të ulët dhe pozicionet të cilat kontestohen nga OE ankues. citoj; 4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të **veçantë për çmimet,** afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive;

b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe

c. **të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut**

Bazuar në të lartcekurat, vlerësojm se pretendimet ankimore gjashtë/shtatë dhe tetë të paraqituara në ankesë janë të qëndrueshme.

Lidhur me pretendimin ankimor numër nëntë, OE ankues pretendon se OE tjetër pjesëmarrës Bastri Ademi B.I., është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar sigurinë e tenderit por vetëm faturën. Eksperti shqyrtues sqaron se, OE një fjalë sipas letrës standarte është eliminuar nga autoriteti kontraktues, i njëjti ka parashtuar kërkesë për ri-shqyrtim, ndërsa AK e ka refuzuar si të pa bazuar me arsyetimin se nuk ka përmbushur kushtin administrativ për shkak se nuk e ka dorëzuar sigurinë e tenderit. Meqenëse oferta e OE Bastri Ademi B.I., është eliminuar nga AK, në rastin konkret vlerësoj se nuk ka ndonjë efekt në aktivitetin e prokurimit pretendimi ankimor ndaj një OE të eliminuar. **Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i tretë i palës në ankesë është pjesërisht i bazuar.**

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirembajtja e veturave zyrtare sipas kerkesave te AK-se (tenderi eshte i ndare ne 4 pjese)" me nr. të prokurimit: "11600-25-4483-2-1-1",

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Gani B. Krasniqi B.I aprovohet si e bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 1, PSH sqaron se ne NJK dhe DT është kërkuar Listën me të cilën specifikohen kontrata ose kontratat për servisimet e veturave të operatorit ekonomik të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar shërbimet, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, bazuar në këtë pretendim PSH ja fala besimin eksperti shqyrtues se OE-ja i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi të mjaftueshme përmes të cilave dëshmohet se i njëjti ka realizuar kontrata për servisimin e automjeteve në tri vitet e fundit në vlerë totale prej 653.009.04€ dhe në rastin konkret e plotëson kërkesën e AK-së, ashtu siç është formuluar në dosje të tenderit dhe njëkohësisht tejkalon vlerën prej 180,000.00 €.

Lidhur me pretendimin nr. 2, Në njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 &9.2, kërkesa nr.3: është kërkuar. Kërkesa 3: Hapësira e objektit të servisit kërkohet të jetë minimum 250 m2 me dokumentacion përkatës zyrtar me pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë: reshjet, era, pluhuri. Hapësira e objektit të servisit, duhet të jetë larg në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë: Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë. (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Evidenca 3: Hapësira e objektit të servisit, të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Hapësira e objektit të servisit, të dëshmohet me dëshmi me shkrim mbi vendndodhjen dhe largësin e servisit në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë, Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Paneli duke u bazur ne dokomentat e ofruar te OE-së se rekomanduar për kontratë me këtë ofertë, ka afruar dokumentacion zyrtar" për objektin. Planimetria, Aktvendimi ne 01-980 i lëshuar nga Komuna e Prishtinës,për ndërtim të *objektit të përkohshëm montazh* për servisimin e automjeteve P+0 tek vendi Bërnicë e Epërme; 2, Certifikaten nga Njësia Kadastrale te datës 03.06.2013 vendi i quajtur mbi rrugë, bashkëpronar me nga ½ Sabit Gashi dhe Mirsad Gashi, lloji i parcelë arë e klasës së tretë me sipërfaqe 813 m2; 3. Faturën e Tatimit në pronë të lëshuar nga Komuna e Prishtinës dt 06.01.2018, në emër të Mirsad Sabit Gashi- Auto servisi MIRI, në të cilë sipërfaqja është 250 m2 ndërsa kategoria e pronës për afarizëm; 4 Fatura e tatimit në pronë nga Komuna e Prishtinës e lëshuar me dt.07.01.2024, në këtë faturë nuk ka as sipërfaqe dhe kategori të pronës; 5 Tri vlerësime të pronave në vitin 2023 tek adresa Bërnicë e Epërme. PSH, konstaton se Në dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi e hapësirave te objektit te prezantuar nga OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk e përmbushë këtë kriter te NJF dhe DT-së, pasi qe nuk ka afruar dëshmi te qarte se *posedone hapësire për servisim me sipërfqaqje prej 250 m2.*

Lidhur me pretendimin nr. 3, AK-ja në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte kërkuarë kërkesat sin ë vijim; Kërkesa 4: Dëshmi mbi disponimin e mjeteve apo pajisjet teknike në dispozicion: Vinç hidraulik për ngritjen e automjeteve – së paku 4 (katër) vinça; Pajisje speciale (kompjuteristike) për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve – së paku 1 (një); Pajisje për vullkanizim dhe balansim të gomave – së paku 1(një); Pajisje për mbushjen e klimave të automjeteve – së paku 1 (një). (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Evidenca 4: Pajisjet e kërkuara të dëshmohen me faturë, foto, ose dokumentacion tjetër dëshmues mbi pronësinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar fajll e emërtuar: "5.Pajisjet_Kapacitetet teknike-me foto, marrëveshje e libreza. Paneli shqyrtues sqaron se, në rastin konkret OE i rekomanduar ka ofruar vetëm fotografi dhe jo dokumente tjera që vërtetojnë pronësinë. PSH sqaron se duhet cekur faktin se nga përshkrimi i kërkesës ne dosje të tenderit si dëshmi është kërkuar faturë, foto ose dokumentacion tjetër dëshmues, foto nuk është dëshmia e vetme që është

kërkuar dhe që dëshmon se OE I rekomanduar për kontratë a i posedon pajisjet e siç kërkohen ne NJF dhe DT. Andaj duke u mbështetur te fotot e OE-së, sqarojmë se fotografitë e dorëzuara me ofertë për disa pajisje nuk mund të vërtetohet se a janë në pronësi te Operatorit ekonomik te rekomanduar për kontratë dhe ne foto nuk ka ndonjë emërtim te pajisjes.

Lidhur me pretendimin nr. 4, PSH konstatone se OE i rekomanduar për kontratë ne ofertë marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve për bartjen e automjeteve e lidhur me dt 25.02.2025 në mes te Isa J. Gashi, B.I ofrues i shërbimeve dhe Mirsad Gashi B.I, marrësi i shërbimeve. Objekt i marrëveshjes është kamioni për bartjen e automjeteve i tipit Mercedezbenz me targa 01-685-QG të cilën e posedon ofruesi i shërbimeve, marrëveshja është e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Dhe kjo kërkesë e prezentuar nga OE-ja I rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin nr. 5, Paneli shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit tek e Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesa me nr.6 kishte kërkuar. *Kërkesa 6: Deklaratë me shkrim për shërbimet, mallrat e ofruara të cilat do të janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).* Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Evidenca 6: Të dorëzohet deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe vulosur nga OE për shërbimet, mallrat e ofruara të cilat do të janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4)

PSH konstaton se OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk e përmbushë këtë kërkesë për arsyeje se deklaratën për kryerjen e shërbimeve në pajtueshmëri me specifikacionin Teknik e ka te pa vulosure dhe në kundërshtim me kërkesat e përcaktuar ne DT. Gjithashtu PSH sqaron se AK-ja nuk mund ti kërkoje sqarim lidhur me vulën duke u bazuar ne nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së dhe nenin 72 paragrafi 2 dhe 3. AK-ja është dashtë te veproje në përputhje me UDHËZUES NR. 002/2024, Neni 10.1., duke eliminuar pa kërkuar sqarim. Për arsyje se kriter ka qenë kërkesa e veçantë në dosje të tenderit, ku është kërkuar që te jetë i nënshkruar dhe vulosur, mungesa e vulës e bënë dokumentin jo të plotë.

Lidhur me pretendimin nr. 6 , Paneli shqyrtues vlerëson se OE-ja I rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta në shumicën e pozicioneve në lot/pjesë 1, lot/pjesë2, lot/pjesë3, lot/pjesë 4. AK, me dt 09.09.2025 përmes platformës eletronike e-prokurimi ka dërguar tek OE i rekomanduar kërkesën për sqarime te tenderit për çmime jo-normalisht të ulëta/larta për lot/pjesën 1, lot/pjesën 2; lot/pjesën 3 dhe lot/pjesën 4 për një numër të madh të pozicioneve. PSH, konstaton se OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjen-deklaratën ndaj kërkesës se AK-së nuk ka bashkangjitur asnjë fakt provë që vërteton çmimet e vendosura në ofertë, janë në përputhje me çmimet e tregut. çmimet e vendosura nga OE-ja I rekomanduar për kontratë, janë çmimet jo-normalisht te ulëta, dhe jo çmimet ne proporcion me tregun ku ne as një nga këto nuk ka arritur ti dëshmoje se janë çmime tregut përderisa në DT Aneksi 1 Specifikacioni Teknike AK-ja ka kërkuar që Pjesët që ndërrohen kërkohet të jenë origjinale, të reja, të paketuara, ambalazhuara nga prodhuesi.

Lidhur me pretendimin nr. 7, Paneli shqyrtues ka analizuar para masën e OE te rekomanduar konstaton se në këtë aktivitet te prokurimit OE i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmimeve jo-normalisht të ulëta në pjesë, dhe të çmimeve te larta për riparime. PSH sqaron vetëm një shembull, alternatorin ka çmimin 11.99 € ndërsa riparimi i alternatorit çmimin prej 150.00€. Në këtë raste AK-ja nuk e ka respektuat nenin 4 paragrafi 1 i RREGULLORES

NR.002/2024 për faktin se OE i rekomanduar për kontratë në ka afruar çmimeve jo reale, ka vendosure çmimi absurde për riparime te pjesëve, ndërsa për ndërrimin e pjesëve qe nënkupton qe duhet te jene te reja dhe origjinale nga prodhuesi ka vendosure çmime jo-normalisht të ulëta, nga kjo nënkuptohet se çmimet e ofruar blerje me riparim nuk janë ne as një rrethanë çmime reale.

Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në Ri-vlerësim, ndërsa ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS**
- OE - **Gani B. Krasniqi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: